



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 59, datë 31.05.2022

PËR

MIRATIMIN PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, DREJTORISË RAJONALE TË OFRIMIT TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Durrës, TE AMBJENTEVE ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 2118 M² (NGA KJO, SIPËRFAQE NDËRTIMI KATI PËRDHE: S1= 170 M²; S2= 470 M² DHE SIPËRFAQE NDËRTIMI KATI PARË S3=1458 M², DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 20 M²), ME VENDODHJE NË ISH REPARTIN E URT-SË, PRONË E BASHKISË, PËR NJË AFAT KOHOR 10 VJET

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenin 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Durrës”, i ndryshuar, shkresës nr. 596 prot., datë 18.11.2021, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Durrës, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria Ligjore, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshtim, Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Durrës, të ambjenteve me sipërfaqe të përgjithshme 2118 m² (nga kjo, sipërfaqe ndërtimi kati përdhe: S1 = 170m²; S2 = 470 m² dhe sipërfaqe ndërtimi

kati parë S3 = 1458 m², dhe sipërfaqe funksionale 20 m²), me vendodhje në ish repartin e URT-së, pronë e bashkisë, për t'u përdorur për formimin profesional, për trajnimin dhe kualifikimin e të rinjve dhe të papunëve në kurse profesionale, të kërkuara nga tregu i punës, për një afat 10-vjeçar, sipas genplanit dhe kontratës bashkëlidhur vendimit dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi




U shpall sot me datë 01.06.2022

Planimetria e Ambienteve në katin perdhe


S1 = 170 m² S2 = 470 m²

Sipërfaqe funksionale 20 m²

SH 1:150



POZICIONIMI I SIPËRFAQES SË KËRKUAR NË OBJEKTIN "ISH URT"



MIRATOI

KRYETAR

Emiriana Sako

DREJTORIA JURIDIKE

Arben Isaku

KONFIRMIMI

PËR SEKTORIN E PRONAVE
DHE MENAXHIMIT
TË ASETEVE

Irma Bushi

Bazuar në Urdhërin
Nr.127, Dt 23.02.2021,
i ndryshuar me Urdhërin
Nr.364, Dt 21.06.2021


PËRGATITI :

Specialist Merita Kërtusha


Specialist Anila Muhja

Specialist Ardita Molla

Planimetria e Ambientit në katin e parë
S= 1458 m²



POZICIONIMI I SIPËRFAQES SË KËRKUAR
NË OBJEKTIN "ISH URT"



DREJTORIA JURIDIKE

Arben Isaku

KONFIRMIMI

PËR SEKTORIN E PRONAVE
 DHE MENAXHIMIT
 TË ASETEVE

Irma Bushi

Bazuar në Urdhërin
 Nr.127, Dt 23.02.2021,
 i ndryshuar me Urdhërin
 Nr.364, Dt 21.06.2021

PËRGATITI :

Specialist Merita Kërtusha

Specialist Anila Muhja

Specialist Ardita Molla



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETEVE

Nr. _____ Prot.

Durrës, më ____ / ____ / 2022

KONTRATË HUAPËRDORJE

Nr.....dt 2022

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM TË AMBJENTEVE, PJESË E
REPARTIT TË URT-SË , ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 2118 M² (NGA KJO,
SIPËRFAQE NDËRTIMI KATI PËRDHE: S1= 170M²; S2= 470 M² DHE SIPËRFAQE
NDËRTIMI KATI PARË S3= 1 458 M², DHE SIPËRFAQE FUNKSIONALE 20 M²), PRONË
E BASHKISË, PËR NJË AFAT KOHOR 10 VJET**

Sot me dt. ____ 05.2022, në ambjentet e Bashkisë Durrës, sipas ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 901 e vijues të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, shkreses nr.596 prot., datë 18.11.2021, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional, Publik Durrës, më lëndë: “Kërkesë”, Vendimit të Keshillit Bashkiak nr.____, datë ____ .2022, “ Për miratimin për dhënien në përdorim, pa kundërshpërblim, Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Profesional, Publik Durrës, të ambjenteve me sipërfaqe të përgjithshme 2118 m² (nga kjo, sipërfaqe ndërtimi kati përdhe: S1= 170m²; S2= 470 m² dhe sipërfaqe ndërtimi kati parë S3= 1 458 m², dhe sipërfaqe funksionale 20 m²), me vendodhje në ish repartin e URT-së, pronë e bashkisë, për një afat kohor 10 vjet, lidhet kjo kontratë huapërdorje, me objekt dhënien në gëzim të përkohshëm, të ambjenteve me sipërfaqe të përgjithshme 2118 m² (nga kjo, sipërfaqe ndërtimi kati përdhe: S1= 170 m²; S2= 470 m² dhe sipërfaqe ndërtimi kati parë S3= 1 458 m², dhe sipërfaqe funksionale 20 m²), pronë e bashkisë, që mban nr.213-215 të listës së pronave, transferuar me VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, me vendodhje në lagjen nr. 17, Rruga “Neki Libohova”, me kushtet si më poshtë:

Huadhënës: Bashkia Durrës, përfaqësuar nga kryetari i bashkisë znj.Emiriana Sako.

Huamarrës: Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional, Publik Durrës, përfaqësuar nga drejtori z. Agim Karaj, me seli në lagjen nr. 17, Rruga “Neki Libohova”, Durrës.



NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 Objekti i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm, pa kundërshpërblim, të ambjenteve me sipërfaqe të përgjithshme 2118 m² (nga kjo, sipërfaqe ndërtimi kati përdhe: S1= 170m²; S2= 470 m² dhe sipërfaqe ndërtimi kati parë S3= 1 458 m², dhe sipërfaqe funksionale 20 m²), pronë e bashkisë, që mban nr. 213-215 të listës së pronave, transferuar me VKM-në nr. 536, datë 01.05.2008, me vendodhje në lagjen nr. 17, Rruga “Rruga “Neki Libohova”, Durrës, pronë e Bashkisë Durrës, sipas genplanit bashkëlidhur, që është pjesë përbëre e kësaj kontrate.

NENI 2 QËLLIMI I PËRDORIMIT


2.1 Qëllimi i përdorimit të ambjenteve të përcaktuar në nenin 1, është për t'i shërbyer *formimit profesional, për trajnimin dhe kualifikimin e të rinjve dhe të papunëve në kurse profesionale, të kërkuara nga tregu i punës.*

NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1 Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.
- 3.2 Kontrata hyn në fuqi në datën e miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak për dhënien në përdorim.
- 3.3 Kontrata nuk ripërtërihet pas kalimit të afatit 10 vjeçar, pa miratimin e shprehur me shkrim të huadhënësit.

NENI 4 DETYRIMET E PALEVE TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUADHËNËSIT

- 4.1 “Huadhënësi” ruan të drejtën e pronësisë mbi objektin e kontratës që i është dhënë huamarrësit, gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj kontrate.
- 4.2 “Huadhënësi” në bazë të kësaj kontrate detyrohet të bëjë dorëzimin me procesverbal të objektit të kësaj kontrate.
- 4.3 “Huadhënësi” garanton huamarrësin për objektin në huapërdorje gjatë gjithë afatit të përcaktuar në kontratë.
- 4.4 “Huadhënësi” nuk mban përgjegjësi për cënimin fizik dhe të jashtëligjshëm të objektit, sikur nuk mban përgjegjësi për detyrimet që rrjedhin në infrastrukturën e brendshme të objektit dhe lidhjen e saj me infrastrukturën e jashtme.
- 4.5 Në qoftë se gjatë afatit të caktuar ose përpara se huamarrësi të ketë pushuar së përdoruri sendin të përcaktuar në kontratë, huadhënësi ndodhet përpara ngjarjeve të ngutshme (fatkeqësi natyrore), ai



mund të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe kthimin e menjëhershëm të sendit.

NENI 5

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E HUAMARRËSIT

- 5.1 “Huamarrësi” detyrohet të mbajë dhe të ruajë sendin, objekt kontrate me përkujdesje.
- 5.2 “Huamarrësi” nuk mund të përdorë sendin objekt kontrate, ndryshe nga përdorimi i caktuar në kontratë.
- 5.3 “Huamarrësi” nuk mund t’ja japë një të treti në përpërdorim sendin objekt kontrate.
- 5.4 “Huamarrësi” detyrohet që ndërhyrjet për përmirësimin e kushteve të ambjenteve, objekt i kontratës së huapërdorjes t’i realizojë me shpenzimet e veta, por vetëm pasi të jetë marrë pëlqimin paraprak nga huadhënësi dhe vetëm me vendim të lejes së ndërtimit e marrë nga bashkia Durrës.

NENI 6

ZGJIDHJA DHE MBARIMI I KONTRATES

- 6.1 Zgjidhja e kontratës mund të bëhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në këtë kontratë, kur palët nuk kanë vendosur ndryshe.
- 6.2 Kontrata e huapërdorjes mund të zgjidhet me kërkesën e huadhënësit edhe para mbarimit të afatit në keto raste:
- a) kur huamarrësi nuk i përdorë ambjentet objekt kontrate sipas destinacionit dhe qëllimit të kontratës.
 - b) kur huamarrësi nuk realizon detyrimet e marra përsipër në projektin e paraqitur me shkresë nr. 596 prot., datë 18.11.2021, drejtuar Bashkisë Durrës dhe në projektet e paraqitura si për kualifikimin e kursanteve dhe përmirësimin e kushteve të ambjenteve objekt kontrate.
 - c) kur huamarrësi e keqpërdor, e dëmton dhe nuk kujdeset për ruajtjen e sendit.
 - d) kur huamarrësi ja kalon sendin një personi tjetër.

Para nënshkrimit të kësaj kontrate huamarrësi është i detyruar që të përpilojë nje akt marrëveshje ku të përshkruhet rezultatet e pritshme si për qëllimin e marrjes së ambjentit me huapërdorje, ashtu dhe përmirësimin e sendit objekt huaje.

Pjesë e kësaj kontrate janë:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. ____, datë ____ .2022.
- Genplane të objektit fletë 4 (katër).
- Shkresa nr.596 prot., datë 18.11.2021, ardhur nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional, Publik Durrës, më lëndë: “Kërkesë” .
- Projekte e paraqitura nga Drejtoria Rajonale e Ofrimit Profesional, Publik Durrës, që bëjnë fjalë si për kualifikimin e kursanteve ndër vitë, ashtu dhe për investimet e pritshme për përmirësimin e kushteve të ambjenteve objekt kontrate.
- Procesverbali i marrjes në dorëzim të ambjenteve objekt kontrate.

REPUBLIKA E

NENI 7

MOSMARRËVESHJET DHE ZGJIDHJA E TYRE

- 7.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë i referohet dispozitave të Kodit Civil në fuqi.
- 7.2 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës.

NENI 8

Kjo kontratë është formuluar në tre kopje origjinale. Një e mban huamarrësi, dy huadhënësi.

HUAMARRËS
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT
PROFESIONAL PUBLIK DURRËS


DREJTORI
Agim Karaj



HUADHËNËS
BASHKIA DURRËS

KRYETAR
Emiriana Sako

A handwritten signature in blue ink, corresponding to the name Emiriana Sako.



15

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 474 / prot.
16

Durrës, më 07.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.59 datë 31.05.2022 “Për miratimin për dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim, Drejtorisë Rajonale të Ofrimit të Formimit Profesional Publik Durrës, te ambjenteve me sipërfaqe të përgjithshme 2118 m² (nga kjo, sipërfaqe ndërtimi kati përdhe: S₁= 170 m²; S₂= 470 m² dhe sipërfaqe ndërtimi kati parë S₃=1458 m², dhe sipërfaqe funksionale 20 m²), me vendodhje në ish-repartin e URT-së, pronë e Bashkisë, për një afat kohor 10 vjet”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

